

KËRKESË
Nr. 6867/7, datë 26.3.2018

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Brendshme shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit: “Për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike, si dhe garantimin e shërbimit publik të varrimit”, në fshatin Zenisht, Bashkia Mat.

Subjekti kërkuar është Bashkia Mat. Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët do të likuidohen për efekt shpronësimi me paraqitjen e dokumenteve të rregullta të pronësisë, pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave, që do të miratojë kërkesën për shpronësim. Vlera totale e shpronësimit është 1 151 400 (një milion e njëqind e pesëdhjetë e një mijë e katërqind) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I BRENDSHËM
Romina Kuko

Lista e pronave dhe e pronarëve që do të shpronësohen për realizimin e projektit
“Për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike, si dhe garantimin e shërbimit publik të varrimit”, në fshatin Zenisht
Bashkia Mat

Nr.	Emër Mbiemër	Nr. i pasurisë	Zona Kadastrale	Sipërfaqja truall/m ²	Çmimi/lekë/m ²	Vlera totale/lekë	Dokumenti i pronësisë
1	Abaz Jakup Dobra	521/6	1319	10100	114	1 151 400	Konfirmuar nga ZVRPP
	Totali					1 151 400	